VENDIM
Nr.2, datë 3.2.2010

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	"	"
Kujtim Puto	Anëtar	i	"	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	"	"
Petrit Plloçi	Anëtar	i	"	"
Vitore Tusha	Anëtare	e	"	"
Sokol Sadushi	Anëtar	i	"	"
Admir Thanza	Anëtar	i	"	"
Sokol Berberi	Anëtar	i	"	"

me sekretare Blerina Çinari, në datën 14.7.2009, mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen me nr.12/5 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Apelit Shkodër.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë**,** përfaqësuar me autorizim nga Lulzim Lelçaj.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar me autorizim nga Marsida Xhaferllari.

Ministria e Drejtësisë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i paragrafit të fundit të nenit 37 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar me ligjin nr.9701, datë 2.4.2007.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, shkronja "d" dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.2598, datë 12.11.2007, ka njohur paditësin E.M. pronar të një ndërtese 50.5 m^2 dhe truallit 202 m^2 me parashkrim fitues. Kjo gjykatë ka vendosur edhe detyrimin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër për të bërë ndryshimet në regjistrat përkatës.

Me vendimin nr.13, datë 9.4.2008, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) ka refuzuar regjistrimin e pasurisë dhe ia ka kaluar praktikën për kompetencë Kryeregjistruesit. Ky i fundit, me urdhrin nr.464, datë 13.05.2008, ka refuzuar kërkesën për regjistrimin e vendimit nr.2598, datë 12.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Shtetasi E.M. ka paditur ZVRPP Shkodër për refuzimin e regjistrimit të vendimit gjyqësor nr.2598, datë 12.11.2007.

Me vendimin nr.1559, datë 30.05.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë me objekt: "...anulimin e aktit administrativ të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme nr.13, datë 09.04.2008 dhe detyrimin e zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) për të nxjerrë një akt administrativ në përputhje me ligjin, duke marrë masat për vendosjen e të drejtës së cenuar të paditësit". Kundër këtij

vendimi paditësi është ankuar në gjykatën e apelit.

Gjykata e Apelit Shkodër, më datë 19.11.2008, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes administrative me nr.1559 të vendimit, datë 30.5.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata e Apelit Shkodër i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese që të shfuqizojë si të papajtueshme me Kushtetutën fjalinë e fundit të nenit 37 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar me ligjin nr.9701, datë 2.4.2007. Kjo dispozitë ka këtë përmbajtje: "*Elementet e vendimit që verifikohen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe procedura e nxjerrjes së urdhrit, përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave"*.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e paragrafit të fundit të nenit 37 të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ndryshuar me ligjin nr.9701, datë 2.4.2007:

- Kompetenca që i jepet regjistruesit për të verifikuar elementet e vendimit të formës së prerë bie ndesh me parimin e balancimit dhe ndarjes së pushteteve, garantuar nga neni 7 i Kushtetutës dhe, e vendos pushtetin gjyqësor nën kontrollin e pushtetit ekzekutiv;
- Nëse një vendim i formës së prerë, dhënë nga gjykata, vihet në diskutim nga një organ administrativ, parimi i sigurisë juridike cenohet dhe individi nuk ka asnjë garanci për zgjidhjen e çështjes në rrugë gjyqësore.

Këshilli i Ministrave ka parashtruar këto argumente për të kundërshtuar kërkesën:

- Sipas nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", duhet të ekzistojë një lidhje e drejtpërdrejtë mes ligjit të kundërshtuar për antikushtetutshmëri dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Në rastin në shqyrtimit, kjo lidhje nuk ekziston, sepse gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër kanë pasur mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykim;
- Çështja e referuar pranë Gjykatës Kushtetuese është përtej kufijve kushtetues të gjyqtarit të zakonshëm dhe priret drejt vlerësimit të vullnetit të Kuvendit nga pikëpamja e oportunitetit politik për rregullimin e çështjeve të caktuara shtetërore;
- Gjykata, në vendimin e pezullimit, nuk përcakton se cili është neni kushtetues apo parimi me të cilit bie ndesh parashikimi ligjor (neni 37);
- Pretendimi për cenim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve nuk ka lidhje me faktet dhe argumentet e paraqitura nga gjykata. Në asnjë fjalë të tij, neni 37 i ligjit nr.9701 nuk i jep zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme funksione gjyqësore;
- Procesi i verifikimit të elementeve të vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, por përkundrazi, e vë atë në jetë;
- Paragrafi i fundit i nenit 37 të ligjit nr.9701 nuk ka defekte kushtetuese dhe është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 100 dhe 118 të Kushtetutës.

Kuvendi i Shqipërisë, si palë e interesuar, i është bashkuar pretendimeve të pakicës në vendimin e pezullimit të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe ka kërkuar rrëzimin e kërkesës.

II

Kërkuesi ka parashtruar se paragrafi i fundit i nenit 37 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar me ligjin nr.9701, datë 2.4.2007, "...bie në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe parimin e sigurisë juridike. Përmbajtja e paragrafit të fundit të nenit të sipërpërmendur është*: "Elementet e vendimit që verifikohen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe procedura e nxjerrjes së urdhrit, përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave"*.

Neni 145, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i njeh të drejtën gjyqtarëve që, në çdo fazë të gjykimit, kur çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese.

Përmbajtja e kësaj dispozite ka të bëjë me kontrollin kushtetues të ligjeve, që për iniciues ka gjykatat e sistemit të zakonshëm.

Në zbatim të dispozitës kushtetuese të përmendur më sipër, ligji nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (ligji i Gjykatës Kushtetuese), në nenin 68, përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata ose gjyqtari për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit përpara Gjykatës Kushtetuese. Së pari, gjykata ose gjyqtari, gjatë një procesi gjyqësor duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti, duhet të parashtrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të ligjit) duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) është shprehur, gjatë jurisprudencës së saj, se gjykata ose gjyqtari duhet të sqarojë me kujdes lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Evidentimi i kësaj lidhjeje është i domosdoshëm në kuptim të nenit 68 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese *(Shih vendimin nr.5, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Duke insistuar në këtë kërkesë, kjo Gjykatë, në një vendim tjetër, është shprehur: "... Para marrjes së vendimit të pezullimit gjyqtari apo gjykata duhet të kenë parasysh që gjykimi që ata kanë nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Pra, gjyqtari duhet të krijojë mendimin se ligji që ai vlerëson si antikushtetues do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes. Në të kundërt, nëse gjyqtari vlerëson se një ligj që sipas tij është antikushtetues nuk do të zbatohet nga ana e tij për zgjidhjen e çështjes, ai duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes. Në mënyrë që të ekzistojë lidhja e drejtpërdrejtë duhet të ketë një raport të domosdoshëm mes vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga kjo gjykatë) dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga gjyqtari apo gjykata, subjekt iniciues i gjykimit incidental, në kuptimin, që gjykimi nga gjykata e zakonshme nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese" *(Shih vendimin nr.13, datë 4.5.2009 të Gjykatës Kushtetuese).*

Në çështjen konkrete, Gjykata e Apelit Shkodër, më datë 19.11.2008, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes administrative me nr.1559, datë 30.5.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese. Kjo gjykatë, në vendimin e pezullimit, ndër të tjera, ka çmuar se neni 37 i ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar me Ligjin nr.9701, datë 2.4.2007 "...që bën të mundur verifikimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave, bie ndesh me parimin kushtetues të sigurisë juridike, që është një ndër parimet e shtetit të së drejtës, për ndërtimin e të cilit bëhet fjalë në preambulën e Kushtetutës".

Gjykata vëren se neni 37 i ligjit nr.9701 është një normë deleguese, e cila i jep Këshillit të Ministrave të drejtën të përcaktojë me udhëzim elementet e vendimit gjyqësor që verifikohen nga ZRPP. Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka arritur të argumentojë, së pari, lidhjen e drejtpërdrejtë që ekziston ndërmjet kësaj dispozite ligjore dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Në arsyetimin e saj kjo gjykatë nuk i përgjigjet pyetjes se pse ajo pengohet nga dispozita objekt shqyrtimi për t'i dhënë zgjidhje çështjes.

Gjykata e apelit i ka shtruar vetes pyetjen nëse mund ta shqyrtojë "...mosmarrëveshjen në fjalë kur ndodhet para një vendimi të formës së prerë, të detyrueshëm edhe për të, dhe nga ana tjetër një vendim administrativ të regjistruesit të bazuar në ligj". Nëpërmjet shtrimit të kësaj pyetjeje Gjykata e Apelit ka lënë të kuptohet se ndodhet përpara një konflikti midis neneve 193/h të Kodit Civil, 451/a të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 37 të ligjit objekt shqyrtimi. Gjykata Kushtetuese, ashtu sikundër është shprehur edhe më parë gjatë jurisprudencës së saj, vlerëson se nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy ligjeve të ndryshme apo ligjeve dhe kodeve. Në juridiksionin e Gjykatës hyjnë papajtueshmëria e ligjeve apo kodeve me Kushtetutën. Mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe për rrjedhojë, nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese *(Shih vendimet nr.11, datë*

27.5.2004 dhe nr.35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata e apelit arsyeton, ndër të tjera, se ajo ndodhet para dy akteve kontradiktore për zbatim, nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe pikës 2 të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 31.1.2007, i dalë në mbështetje të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994, ku punonjësit të ZRPP-së i jepet e drejta e verifikimit të elementeve të formës dhe përmbajtjes së vendimeve gjyqësore. Gjykata e apelit, nëpërmjet këtij arsyetimi, siç u përmend dhe më sipër, nuk ka arritur të përmbushë detyrimin për përcaktimin e ligjit/aktit ku kjo gjykatë është e detyruar të mbështetet për zgjidhjen e çështjes konkrete. Duke qenë e pasigurt për aktin ku duhet të mbështetet, vetë kjo gjykatë nuk mundet të arrijë në një qëndrim për sa i përket këtij detyrimi.

Gjykata e çmon të nevojshme të theksojë se, në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët iu nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës, si detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës). Në këtë kuptim, nëse gjyqtari gjatë një gjykimi, arrin në përfundimin se ligji dhe akti nënligjor, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes, bien në kundërshtim me njëri-tjetrin, ai është i detyruar të bazohet në ligj. Gjyqtarët duhet të kenë parasysh dhe raportet ndërmjet ligjeve që miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (ligje të përforcuara), sipas nenit 81/2 të Kushtetutës dhe ligjeve që miratohen sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar nga neni 78 i Kushtetutës. Kushtetuta i jep ligjeve të përforcuara fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ato renditen para ligjeve të zakonshme të Kuvendit (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 3.5.2007*). Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër *(lex superior derogat inferiori*). Parimet, se norma specifike ka përparësi nga norma e përgjithshme *(lex specialis derogat generali)* dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme, nuk veprojnë në raste të tilla.

Bazuar në vlerësimet e bëra më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka arritur të argumentojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis zgjidhjes së çështjes konkrete dhe dispozitës ligjore që kundërshtohet për papajtueshmëri me Kushtetutën.

Sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e pabazuar në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar) Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Sokol Sadushi, Sokol Berberi, Admir Thanza.